

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË /DIVIZ.KUNDËRVAJTJËS/, me Gjyqtarin Nehat Qelaj dhe sek.juridike Nexhmije Dakaj në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Reshit Ahmet Krasniqi nga Malisheva, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7 paragrafi i ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet (LMK) me dt.16.12.2013, mori këtë:

A K T V E N D I M

Dep.	DPK/OMP	Nr. Prot.	
Dep.		Br. Prot.	03-4547/13
Nr. i faq.		Prot. No.	
Broj. stranica	02	Data	31.12.2013
Nr. pages		Datum	

I pandehuri: Reshit Kryeziu nga i ati Ahmet i lindur me datën 19.10.1961 në fshatin Savrov K.Suharekës, ndërsa tani me banim në rrugën „Hamdi Berisha“ lagjeja e Mirdites në Malishevë, i martuar i ati i dy (2) fëmijëve, zyrtar Kryesor Financiar në Komunën e Malishevës, ka të kryer fakultetin Ekonomik-master, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R.Kosovës,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S :

Sepse në afatin prej 01 deri 31 Mars 2012 si zyrtar Kryesor Financiar në Komunën e Malishevës nuk e deklaroi pasurinë e tij me ç'rast nuk e përmbush obligimin ligjor që parahihet me nenin 5 dhe 6 paragrafi 1.1 të ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 7 të ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

- prandaj në bazë të këtyre dispozitave dhe në kuptim të nenit 17 paragrafi 1.2 të të njëtit ligj si dhe konform nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i njëjti :

D Ë N O H E T

Me gjobë në shumën prej katërqindpesdhjet euro (450 €)

Obligohet i pandehuri që gjobën e shqiptuar të paguan në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi në xhirologari të Këshillit Gjyqësor No.1000 4300 7000 0518, në të kundërtën e njëjta do të zëvendësohet me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetegjashtë (36) ditësh duke llogaritur 15 euro për një ditë burg, po ashtu i pandehuri obligohet që në afat të lartcekur të paguaj 10 € në emër të paushallit gjyqësor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtruesi i kërkesës dhe i pandehuri.

A R S Y E T I M

Agjensioni Kundër Korrupsionit parashtrroi kërkesën nr.01-4278/2012 të datës 26.11.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Reshit Ahmet Krasniqi nga Malisheva, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7 paragrafi i ligjit nr. 04/1-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Për shqyrtimin e kësaj qështje gjyqtari i qështjes caktoi senac dhe ftoi të pandehurin që me datën 23.04.2013 të paraqitet në gjykatë që të deklarohet në mbrojtjen e tij për kundërvajtjen me të cilën ngarkohet.

Në gjykatë sipas ftesës së kësaj gjykate është paraqitë I pandehuri dhe në seancës e datës 23.04.2013 pasi që i'u komunikua kërkesa për hapjen e procedurës kundërvajtëse ndaj tij dhe kundërvajtjen me të cilën ai ngarkohet i njëjti për këtë çështje deklaroi se:

03-4547/13/02
Aug.

është e vërtet se për vitin 2012 nuk e kam bërë deklarin e pasuri tek agjensioni kundër korrupsion mirp un personalisht as nga agjensioni e as nga zyrtari Komunal nuk kam qen i njoftuar qen i njoftuar qe ta bej deklarin e pasuris. Sikur te kisha informacion do ta deklaraja pasurin pa hezitim dhe nuk do ti iki ketij obligimi ligjor. Dua te theksoj se ne nji far menyre Agjensioni Kundër Korrupsion ka informacion per pasurin time sepse bashkëshortja ime Hasime Krasniqi deputete e parlamentit te Kosoves per vitin 2012 ne ket Agjension e ka ber deklarin e pasuris pjes e se cilës jam edhe une. Njeherit ju informoj pasi jam njoftuar per obligimin ligjor per deklarin e pasuris per vitin 2013 e kam bere deklarin e pasuris andaj kosideroj se kjo dëshmon se un i pergjigjem qdo obligimit ligjor.

Lidhur me këtë çështje me datë 28.10.2013 si dëshmitar është ndëgjuar Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit I cili lidhur me këtë çështje deklaroi se sa i përket deklarin te pasuris të antarit te zyrtarit kryesor Financiar te KK-Malishevës konkretisht për Reshit Krasniqi me plot pergjegjësi e them se të njëjtin në muajin shkurt 2012 e kam njoftuar gojarisht ne zyren e tij që të bëjë deklarin e pasuris sipa ligjit me nr.04/.L-050.

Gjyqtari i çështjes pas dëgjoi të pandehurin dhe pas shiqimit të lëndës në tërsi e pa të arsyeshme të ndëgjoj Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit pasi që në shkresat e lëndës vërhet se i njëti ka vepruar sipas kërkesë së Agjensionit të cekur më lart duke e njoftuar me shkrim agjensionin për listen e zyrtarëve të lart publik që kërkohet sipas ligjit 04/L-50 për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë e që në këtë list është edhe i pandehuri në fjalë.

Njëkohësisht gjyqtari vlersoi deklaratën e të pandehurit, pretendimin e tij se nuk ka qen i njoftuar as nga agjensioni e as nga zyrtari Komunal, megjithëkëtë pjesërisht i fali besimin pretendimit të tij se **nuk ka qen i njoftuar**, njeherit gjyqtari vlerësoi deklaratën e Muharrem Morina pikë kontaktuesë në mes të KK Malishevës dhe Agjensioni Kundër Korrupsionit dhe e mori si bindëse dëshmin e tij ku thekson se; me plot pergjegjësi e them se të njëjtin në muajin shkurt 2012 e kam njoftuar gojarisht ne zyren e tij që të bëjë deklarin e pasuris sipa ligjit me nr.04/.L-050.

Pas këtij konstatimi gjyqtari i administroi provat në tërsi dhe analizoi edhe shkresat tjera të lëndës dhe duke u bazuar edhe në kërkesën e Agjensioni Kundër Korrupsionit konstatoi dhe gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga dispozitat e shënuara më lartë andaj duke marrë për baze nenin 7 të LMK-së dhe më pas duke u thirrur edhe në nenin 9 të LMK-së i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktvendimit me bindje se edhe me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit, dhe se do të ndikoj pozitivisht tek I pandehuri që në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngajshme.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në bazë të nen.7 të LMK-së ,ku si rrethan rëndues vlersoi peshën dhe rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, ndërsa si rrethan lehtësues mori sjelljen korrekte të pandehurit në gjykatë, ka pranuar se nuk e ka deklaruar pasurin, në njëfar mënyre pasuria e tij është paraqitur tek agjensioni për mes bashkëshortës së tij që është deputet e parlamentit të Kosovës, deklariminin per vitin 2013 e ka bere që si dëshmi ka deponuar vërtetimin e lëshuar nga agjensioni, kushtet ekonomike të tij, prandaj duke pas për bazë këto rrethana iu shqiptua dënimi i theksuar më lartë.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore, është marrë në bazë të nenit 109 par.2 të LMK-së.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË / DIVIZIONI KUNDËRVAJTJES/
Regj-V-nr.6791/2012 të dt.16.12.2013



Sek.juridik
Nexhmije Dakaj

Gjyqtari
Nehat Qelaj
Nehat Qelaj

UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi kanë të drejt ankese I pandehuri dhe parashtuesi I kërkesës, Gjykatës së Apelit /Divizionit për Kundërvajtje, në Prishtinë në afatin prej 8 ditësh, pas marrjës së të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.